**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 21/84
Datë: 22.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për themelimin e Fondit të Konfiskimit.

2. Obligohen Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

---

# KONCEPT DOKUMENTI PËR FONDIN E KONFISKIMIT

**Qershor 2022**

## Përmbledhje e Koncept Dokumentit

| **Informacionet e përgjithshme** | |
|---|---|
| **Titulli** | Koncept Dokumenti për Fondin e Konfiskimit |
| **Ministria bartëse** | Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuara |
| **Personi kontaktues** | Fadil Bunjaku, Z.V. Drejtor i Përgjithshëm i AAPSK-së |
| **Prorgrami i Qeverisë** | Prioriteti, Sundimi i ligjit pjesa 2.2 |
| **Prioritetin Strategjik** | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br><br>Avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe krijimi i fondit përmes ndarjeve të rregullta buxhetore [1];<br><br>Planin e Punës Objektivi i 5 (pestë) strategjike zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas në fushën e drejtësisë, ka përcaktuar avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe krijimin e fondit të konfiskimit përmes krijimit të linjës së veçantë buxhetore[2] nëpërmjet hartimit të një ligji ose plotësim ndryshimin të ligjit për administrimin e pasurisë se sekuestruar dhe të konfiskuar |

[1] Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, Lista e Objektivave të Ministrisë së Drejtësisë për programin e Qeverisë 2021-2025.

[2] Shiko masat 5.2Avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar në Planin Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë 2018-2021, Prishtinë tetor 2018. Linku https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/3AC6E9A1-397D-47E0-8804-78A1E04D301A.pdf

| **Vendimi** | |
|---|---|
| **Çështja kryesore** | Themelimi i Fondit të Konfiskimit |
| **Përmbledhje e konsultimeve** | Janë kryer konsultimet paraprake dhe konsultimi publik përmes platformës online |
| **Opsioni i propozuar** | Opsioni i tretë është opsion i propozuar |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| **Ndikimet buxhetore** | Në tabelat e mëposhtme janë dhënë ndikimet buxhetore |
| **Ndikimet ekonomike** | Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori |
| **Ndikimet shoqërore** | Ndikimi në qeverisje- trajtimi i barabartë dhe informimi më i mirë i publikut; të drejtat dhe siguria juridike për rregullimin e fondit të konfiskimit në formë të programit të konfiskimit |
| | |
| **Ndikimet në të drejtat e njeriut** | Nuk pritet të ketë cenim të drejtave të njeriut |
| **Ndikimet mjedisore** | Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| **Afatshkurter** | 1 Hartimi dhe miratimi i plotësim/ndryshimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar<br>2) Informimi i institucioneve përgjegjëse për këtë politikë të re |
| **Afatmesem** | Harmonizimi i këtij ndryshimi i ligjit për buxhetin gjatë procesit të rregullt buxhetor të përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë |

## HYRJE

**<u>Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për Koncept Dokumentin</u>**

| | |
|---|---|
| **Titulli** | Koncept Dokumenti për Fondn e Konfiskimit |
| **Ministria bartëse** | Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuara |
| **Personi kontaktues** | Fadil Bunjaku, Z.V. Drejtor i Përgjithshëm i AAPSK-së |
| **Plani Strategjik Operacional** | Prioriteti, Sundimi i ligjit pjesa 2 |
| **Prioritetin Strategjik** | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2022-2025<br><br>Avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe krijimi i fondit të veçantë përmes krjimit të progamit të konfiskimit brenda buxhetit nga mjetet e grumbulluara<br><br>Planin e Punës Objektivi i 5 (pestë) strategjike Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas në fushën e drejtësisë, ka përcaktuar avancimi i sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe krijimin e programit të të konfiskimit nëpërmjet hartimit të një ligji ose plotësim ndryshimin e ligjit për administrimin e pasurisë se sekuestruar dhe te konfiskuar në të cilin do të përfshihet programi i konfiskimit i konfiskimit. |
| **Grupi punues** | 1. Fadil Bunjaku, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i AAPSK-së; Kryesues;<br>2. Ruzhdi Osmani, Udhëheqës i Divizionit për Integrime Evropiane; DIEKP,MD, Zëvendës kryesues<br>3. Arben Ismajli, Prokuror- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, anëtar<br>4. Fidan Hoxha, Gjyqëtar, Gjykata Themelore Prizren, anëtar;<br>5. Valmira Uka, Zyrtare e Lartë ligjore, DL, MD,anëtare;<br>6. Asllan Kukaj, Shef i Sektorit të Financave, DBF, anëtar;<br>7. Liridona Zeqiri, Zyrtare e Lartë për Integrime Evropiane, anëtare, AAPSK |

| | |
|---|---|
| | 8. Florentina Beqiraj, Koordinatore e Njësisë për të drejtat e njeriut, anëtar<br>9. Qëndresa Mustafa, U.D. Udhëheqëse e Divizionit për Komunikim Publik, anëtare<br>10. Alberita Hyseni, Zyrtare e Lartë ligjore, ZKM, anëtare<br>11. Alba Bonjaku, Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave SKQ/ZKM, anëtare<br>12. Gëzim Bislimi, Analist i Lartë i Buxhetit/MF, anëtar<br>13. Kushtrim Canolli, Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikav, ZPS/ZKM, anëtar<br>14. Adison Gara, Zyrtar i Lartë, Divizionit për Gjyqësor dhe të drejtat themelore, MIE, anëtar |

## Kapitulli 1:

## 1.1 Përkufizimi i Problemit

Ministria e Drejtësisë si dikaster i Qeverisë së Republikës së Kosovës, vend të veçantë dhe shumë të rëndësishëm i ka dhënë aktiviteteve që mundësojnë efikasitet sa më të lartë në fushën e drejtësisë, kjo Ministri në Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë, Objektivi 5 (pestë) Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas të sistemit të drejtësisë, si objektiv strategjik ka përcaktuar, avancimin e sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar dhe ka përcaktuar themelimin e Fondit në formë të programit të Konfiskimit nëpërmjet hartimit të një ligji ose plotësim ndryshimin e ligjit për Administrimin e pasurisë se sekuestruar dhe të konfiskuar. [3].

Meqenëse tani me legjislacionin penal dhe me Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar[4] është rregulluar çështja e konfiskimit të pasurive dhe administrimi i tyre, aktualisht si çështje mjaft e rëndësishme mbetet vetëm rregullimi sa më i detajuar i trajtimit të pasurisë së konfiskuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata, duke ngritur një program të Konfiskimit si dhe duke caktuar kriteret për përdorimin e pasurive të konfiskuara.

Deri me tani nuk kemi ndonjë ligj apo akt nënligjor i cili do të rregullonte çështjen e programit të konfiskimit. Mungesa e një ligji të tillë ndikon negativisht në zhvillimin e programeve të ndryshme të cilat kanë për qëllim avancimin e institucioneve në luftën kundër krimit dhe pasurimit nga veprat penale. Krijimi i një baze ligjore për programin e Konfiskimit do të hapte rrugën që pasuria e konfiskuar të shfrytëzohet për organet e drejtësisë penale të cilët kontribuojnë në konfiskimin e pasurisë së jashtëligjshme (gjyqësori, prokuroria, doganat, NjIF-i, AAPSK, kompensimi i viktimave etj.) dhe për projekte të ri-përdorimit shoqëror, gjithashtu ky program në vete do të përmbante edhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të konfiskuara nga organet e nivelit lokal aty ku pasuritë gjenden me qëllim që të përdoren në të mirë të komunitetit.

Problemi qëndron edhe në atë se Kosova nuk është në përputhje me praktikat e mira ndërkombtare të cilat kërkojnë që vendet të krijojnë një mekanizëm për të vendosur se si të përdoren pasuritë e konfiskuara nga veprat penale. Aktualisht të ardhurat nga shitja e pasurisë së konfiskuar kalojnë në buxhetin e shtetit sipas Kodit të Procedures Penale, nuk ka dispozita për ripërdorim social, ka pengesa për transferimin e pasurive të konfiskuara kriminale për përdorim nga qeveria në përputhje me KPP-në dhe nuk ka dispozita për të

[3] po aty faq.10 dhe 34 ( aktiviteti i 4 Krijimi i një "fondi" të konfiskimit )

[4] Ligji nr. 05/l-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 12 / 14 prill 2016, Prishtinë Linku : https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360

nxitur agjencitë ligjzbatuese dhe gjykatat nga programi për të përmirësuar performancën e konfiskimit.[5]

*Vendet BE-së dhe* vendet e rajonit çështjen e përdorimit të pasurive të konfiskuara e kanë të rregulluar dhe kanë krijuar mundësinë për përdorimin e tyre qoftë nga shoqëria por edhe për programe të caktuara për kompensim të viktimave si dhe për përkrahjen e programeve të ndryshme për trajtimin e personave të varur nga drogat.

Krahas kësaj mungesa e mjeteve buxhetore ka kufizuar edhe zhvillimin e politikave të ndryshme të cilat do të ndihmonin institucionet ligjzbatuese në ngritjen e kapaciteteve për luftimin e krimit, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023[6], theksoi nevojën për të siguruar burime adekuate për ato agjenci të ngarkuara me luftimin e krimit të organizuar. Plani i Veprimit detajon një numër të madh aktivitetesh që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

Në tabelën e mëposhtme identifikohen dokumentet strategjike relevante dhe aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me çështjen që trajton ky Koncept Dokument. Po ashtu precizohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre akteve si dhe roli dhe detyrat e institucioneve zbatuese të ligjit.

[5] Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III), Dokument Teknik, Shqyrtimi i Koncept Dokumentit të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë (Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara) për krijimin e Fondit të Konfiskimit, faqe 5

[6] Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 Linku : https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DBA6BCC4-B875-4A30-9FDB-C144736597B2.pdf

***Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore***

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor** | **Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës (e)për zbatim** | **Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)** |
|---|---|---|---|
| KODI NR. 06/L-074<br><br>KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413 | Ministria e Drejtësisë<br><br>Gjykatat | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:**<br><br>Kur gjykata arrin në përfundim që i akzuari është përgjegjës për vepren penale dhe nga ajo vepër ka përfituar pasuri ose ka përdorur mjete për ta kryer atë vepër, pasuria konfiskohet |
| KODI NR. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861 | Ministria e Drejtësisë<br><br>Gjykatat | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** *Gjykatat* në bazë të KPP-së ndër të tjera shqyrtojnë kërkesat e prokurorisë për urdhërin e sekuestrimit të përkohshëm dhe vendosin lidhur me ato kërkesa, shqyrtojnë kërkesat për lëshimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe vendosin për këto masa, shqyrton kërkesat për lëshimin e urdhërit kufizues, lëshon urdhër të arsyetuar për konfiskimin e pasurisë[7], etj.<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Ndër të tjera Prokurori i Shtetit në kuadër të KPP-së është përgjegjës për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë së kundërligjshme, kufizimin e përkohshëm të pasurisë, mund të lëshoj urdhër për ngrirjen e përkohshme të pasurisë, përkatësisht, ndalimin e shitjes, shkëmbimit të pronësisë ose tërheqjen nga llogaria të cilitdo send i cili dyshohet se është përdorur në veprën penale nën hetim apo është fituar nga vepra penale nën hetim, kërkesën për urdhër për sekuestrim të përkohshëm, kërkesën për urdhër ndalues, përfshirjen e pasurisë së konfiskuar në aktakuzë, mund të kërkoj transferimin te Qeveria e Kosovës për shfrytëzim të |

[7] Shiko nenin 112 , 273 , 284 Kodi Nr. 04/l-123 i Procedures Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë.

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Prokurori i shtetit | automjeteve apo pasurive tjera për të cilët është bërë sekuestrimi i përhershëm[8] etj.<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës të jetë kryer dhe ia raporton ato prokurorit te shtetit. Zyrtarit të autorizuar të policisë mund t'i delegohet mbikëqyrja dhe kontrolli i sendeve dhe pasurisë së sekuestruar përkohësisht etj. |
| LIGJI Nr. 06/L-087<br><br>PËR KOMPETENCAT E ZGJERUARA PËR KONFISKIMIN E PASURISË | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18337 | Ministria e Drejtësisë<br><br><br><br><br>Gjykatat | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Gjykata sipas LKZKP-së ndër të tjera vendos lidhur me kërkesën për verifikim të pasurisë dhe kërkesa të tjera të prokurorit, nxjerr një urdhër kufizues përfundimtar, mban seancë dëgjimore për verifikim të pasurisë si dhe mund të vazhdojë procedurat penale dhe procedurat për konfiskimin e zgjeruar në rastet e vdekjes, mungesës, çrregullimit ose paaftësisë mendore të të pandehurit, bën konfiskimin e pasurisë së të pandehurit të fituar në mënyrë jolegjitime [9]etj.<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Prokurori i shtetit është i autorizuar përmes LKZKP-së të bëj kërkesën për verifikimin e pasurisë së të dënuarit, provon se pasuria e paraqitur në kërkesën për verifikim të pasurisë është pronë e të pandehurit, paraqet kërkesë për urdhër kufizues përfundimtar, mund të iniciojë një hetim për konfiskim, mund të kërkojë urdhër për zbulim të informacionit,[10]etj. |
| LIGJI Nr. 05/L-049<br><br>PËR ADMINISTRIMI | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360 | Ministria e Drejtësisë | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** AAPSK ruan dhe adminstron me pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke |

[8] Shiko nenin 112, 264, 269 ,284,274 284 Kodi Nr. 04/l-123 i Procedures Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë

[9] Shiko nenin 5,6, 9 ,12, 19 të Ligji Nr. 06/l-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

[10] Shiko nenin 5, 9, 10, 18 19 të Ligji Nr. 06/l-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

| | | | |
|---|---|---|---|
| N E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR | | AAPSK | përfshirë magazinimin, ruajtjen e përkohshme, shitjen e pasurisë, dhënien me qira, dhënien në shfrytëzim pa kompensim dhe vlerësimin e vlerës së pasurisë së konfiskuar në pajtim me ligjin, derdhjen e mjeteve në të holla të fituara nga shitja e pasurisë së konfiskuar në pajtim me ligjin dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm për të ruajtur dhe mbajtur vlerën e pasurisë;[11]etj. |
| UDHËZIMI ADMINISTRATIV MD NR. 05 /2017 PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E SHITJES SË PASURIVE TË LUAJTSHME TË SEKUESTRUARA | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15442 | Ministria e Drejtësisë<br><br>AAPSK | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, AAPSK mirëmbanë regjistrin e të gjitha pasurive të marra në kujdesin e saj, merr përgjegjësinë mbi pasurinë dhe merr në pranim pasurinë, caktimin e vlerës së sendeve, zhvillon procedurë të veçantë për të shitur pasurinë [12]etj. |
| UDHËZIM ADMINISTRATIV MD/ NR.04/2017 PËR MËNYRËN E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE TË RUAJTJES DHE TË MBAJTURIT E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15317 | Ministria e Drejtësisë<br><br>AAPSK | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Bartë shpenzimet për administrimin e pasurisë së sekuestruar. |

[11] Shiko nenin 2 të Ligji Nr. 05/l-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

[12] Shiko nenin 4,5,6,9 të Udhëzimi Administrativ Md Nr. 05 /2017 për Mënyrën dhe Procedurën e Shitjes së Pasurive të Luajtshme të Sekuestruara

## *1.2 Problemi kryesor*

Në vazhdim do të trajtohet problemi që targeton ky Koncept Dokument njëkohësisht me shkaqet që vlerësohen se kanë ndikuar në krijimin problemit në fjalë. Rëndësi do t'i kushtohet edhe efekteve që janë paraqitur dhe mund të vazhdojnë të paraqiten si pasojë e shkaqeve të evidentuara. Krahas tabelës në vijim, është paraqitur edhe pema e problemit që konsiston në problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij. Të njëjtat gjithashtu janë analizuar në pjesën narrative si më poshtë.

| | |
|---|---|
| ***EFEKTET*** | ➢ Papajtueshmëri me kërkesat ndërkombëtare; |
| | ➢ Mos interesimi i shoqërisë për të kontribuar në luftimin e krimit dhe konfiskimit |
| | ➢ Mos stimulimi i organeve te drejtesise per te ngritur performancen e konfskimit |
| **PROBLEMI KRYESOR** | ➢ Pamundësia e përdorimit të pasurive të konfiskuara për ripërdorimin shoqërorë, për kompensimin e viktimave të krimit, për ngritje të kapaciteteve profesionale në fushën e konfiskimit.<br>➢ Pa pajtushmëri me rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar |
| **SHKAQET** | ➢ Mungesë e dispozitave ligjore për themelimin e Fondit përmes programit të Konfiskimit |
| | |

**Figura 3: Pema e problemit, shkaqet dhe efektet**

Në vijim janë radhitur disa prej shkaqeve të cilat janë pengesë për përdorim të pasurive të konfiskuar për ripërdorim shoqërorë, për kompensimin e viktimave ts krimit, për ngritje të kapaciteteve profesionale në fushën e konfiskimit**.**

**Shkaku**

Mungesë e dispozitave ligjore për themelimin e Programit të Konfiskimit

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme paraqet një sfidë mjaft të madhe, andaj lufta kundër kësaj dukurie është çështje praktike dhe jo vetëm teorike, e cila përcakton gatishmërinë e institucioneve për ta luftuar kriminalitetin, mirëpo një luftë e suksesshme kërkon mjete financiare dhe një infrastrukturë e kompletuar ligjore e cila do të ndikonte në luftimin e suksesshëm të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Paralelisht me krijimin e infrastrukturës ligjore për konfiskimin dhe administrimin e pasurisë së konfiskuar duhet të krijohet edhe baza ligjore për shpërndarjen e pasurisë së konfiskuar nga veprat penale.

Në këtë drejtim siç është theksuar edhe me lartë Republika e Kosovës nuk ka ligj për Fondin përmes programit të Konfiskimit një fakt i tillë rreth mungesës së Programit të Konfiskimit është specifikuar edhe në analizat e bëra nga ekspertet e projektit të financuar nga BE-ja, në mbështetje të mëtejshme të institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ku theksohet se: "*Që nga gushti i vitit 2017, pothuajse tre vjet pas raportit të projektit 'PECK', Kosova ende nuk ka themeluar një fond të pasurive të konfiskuara*". Gjithashtu Republika e Kosovës nuk ka arritur të plotësoj në tërësi rekomandimin e 38 të FATF-së ku Theksohet që*: "Vendet duhet të konsiderojnë krijimin e një fondi të konfiskimit të pasurive, në të cilin të gjithë, ose një pjesë e pasurisë së konfiskuar do të destinohen për zbatimin e ligjit, shëndetësinë, arsimin, ose qëllime të tjera të përshtatshme*[13]*"...*

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, e cila mbanë përgjegjësi për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruara dhe të konfiskuara që i janë besuar në përkujdesje me vendim nga gjykata, ndërmerr veprime për ekzekutimin e vendimeve të dërguara nga gjykata dhe pasuritë e konfiskuara i shet dhe të hyrat e realizuara

---

[13] **Interpretive Note To Recommendation 38 (Mutual Legal Assistance: Freezing And Confiscation)** Countries should consider establishing an asset forfeiture fund into ëhich all, or a portion of, confiscated property ëill be deposited for laë enforcement, health, education, or other appropriate purposes. Countries should take such measures as may be necessary to enable them to share among or betëeen other countries confiscated property, in particular, ëhen confiscation is directly or indirectly a result of coordinated laë enforcement actions, Linku : https://ëëë.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF%20Recommendations%202012.pdf

nga shitja derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës, mirëpo krahas kësaj Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar i AAPSK-së nuk parasheh ripërdorimin e pasurive për qëllime shoqërore apo krijimin e një Fondi të Konfiskimit i cili do të mundësonte  që një pjesë e këtyre të hyrave nga shitja e pasurive të konfiskuara të përdoren për qëllime shoqërore apo qeveritare.

Aktualisht, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës[14], trajton shfrytëzimin e pasurisë se konfiskuar, i cili i parasheh si vijon:

*"Prokurori i shtetit mund të kërkojë që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti të mbahen për shfrytëzim nga Qeveria e Kosovës".*

*"Nëse mjetet konfiskohen drejtpërdrejt apo nëpërmjet paragrafit 3. të këtij neni, prokurori i shtetit, i dëmtuari ose mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë që mjetet të përdoren për kompensimin e të dëmtuarit. Mjetet e mbetura i kalohen buxhetit të shtetit".*

*"Urdhri nga paragrafi 1. i këtij neni udhëzon Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar që të shesë, likuidojë ose të mbajë ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin. Nëse paraqitet kërkesë nga paragrafi 5. të këtij neni. I këtij neni, gjykata mund të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të përcaktojë kushte shtesë lidhur më përdorimin e pasurisë, nëse pasuria mbahet nga Qeveria".*

Gjithashtu, *me kërkesë të prokurorit të shtetit, automjetet apo aeroplanët për të cilët është bërë sekuestrimi i përhershëm mund t'i transferohen Qeverisë së Kosovës për shfrytëzim, nëse transferimi i tillë nuk e zbeh mundësinë e të dëmtuarit për të siguruar kompensimin*[15].

Mirëpo këto dispozita ligjore nuk janë të mjaftueshme edhe nuk e rregullojnë çështjen e shfrytëzimit të pasurisë së konfiskuar për ripërdorim social, gjithashtu edhe për viktimat është e vështirë realizimi i së drejtës  në kompensim kur kemi parasysh faktin që viktimat nuk janë të njoftuara për të drejtat procedurale.

Shumë vende të rajonit kanë themeluar Fondin e Konfiskimit që mbanë pasuritë edhe paratë e grumbulluara nga pasuritë e konfiskuara, në këtë drejtim  paratë në Programin  e Konfiskimit mund të shpërndahen për ri-përdorim social, për viktimat e krimit dhe për

---

[14] shiko nenin 284 Kodi Nr. 04/l-123 i Procedures Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë. Linku : https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861

[15] po aty nenin 115 pargarafi 6,

financimin e agjencive të zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë për të rritur kapacitetin e tyre të vazhdueshëm për të luftuar krimin përmes përpjekjeve të mëtejshme për konfiskim.

Për mungesë të një politike të përdorimit të pasurive të konfiskuara është specifikuar edhe nga akterët ndërkombëtarë dhe se krijimi i saj është paraparë si çështje urgjente, andaj nëpërmes këtij koncept dokument synojmë që t'i adresojmë mangësitë e ligjit aktual për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, duke e ri hartuar ligjin në mënyrë që këto mangësi të eliminohen dhe të krijohet baza ligjore për krijimin e Programit të Konfiskimit.

Rishikimi i kornizës legjislative të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar në Kosove dhe krijimi i bazës ligjore për programit të konfiskimit do të bëhet në kuadër të avancimit të kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet dhe qëllimet e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

**Efektet-**

Në kuadër të asaj që u tha më lartë, shkaqet e problemit kryesor kanë ndikuar në paraqitjen e pa pajtueshmërisë me kërkesat ndërkombëtare, Mos interesimin i shoqërisë për të kontribuar në luftimin e krimit dhe konfiskimit, mos stimulimi i organeve të drejtësisë për të ngritur performancen e konfiskimit.

**Efekti 1-Pa pajtueshmëra me kërkesat ndërkombëtare**

Standardet ndërkombëtare për Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimi i Terrorizmi dhe Përhapja, Rekomandimet e FATF-së[16], kërkojnë që vendet/ shtetet duhet të themelojnë një Fond të Konfiskimit nga i cili një pjesë e pasurisë ose e tërë pasuria do të destinohet për shfrytëzim nga institucionet ligj zbatuese, si shëndetësia, arsimi etj.

Shkaqet e cekura më lartë dhe mungesa dispozitave ligjore për shpërndarjen e pasurisë së konfiskuar nga veprat penale ka sjell që Kosova mos të përmbushë plotësisht kriterin e 38 të rekomandimeve të FATF-së, ku edhe është vlerësuar që Kosova është pjesërisht në përputhje me këtë rekomandimin.

**Efekti 2 Mos interesimi i shoqërisë për të kontribuar në luftimin e krimit dhe konfiskimit**

Mungesa e një programi të konfiskimit ndikonë që shoqëria të ketë interesim të ultë në inicimin e procedurave penale ku do të pasonin me konfskimin e pasurisë e cila është përfituar ose është përdorur në kryerjen e veprës penale, ndërsa në anën tjetër themelimi i një programi cili në vete do të përmbante edhe komponenten e përdorimit të mjetëve të cilat janë konfiskuar nga kriminelët, për

[16] Theksohet që " Kriteri 38. "Vendet duhet të konsiderojnë krijimin e një fondi të konfiskimit të pasurive, në të cilin të gjithë, ose një pjesë e pasurisë së konfiskuar do të destinohen për zbatimin e ligjit, shëndetësinë, arsimin, ose qëllime të tjera të përshtatshme[16]"...Linku : https://ëëë.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF%20Recommendations%202012.pdf

projekte nga të cilat do të përfitojnë qytetarët e Kosovës në përgjithësi, dhe viktimat e krimit në veçanti.

Përdorimi i mjeteve të cilat janë pjesë e programit të Konfskimit për programe të caktuara shoqërore ose në të mirë të komunitetit ndikon në ngritjën e besimit të qytetarve në oraganet e drejtesisë dhe gjithashtu do të jete më arsyeshme se sa  vetëm përdorimi për institucionet qeveritare.

Në këtë kontekst, duhet theksuar fuqishëm se programi buxhetor që nuk ka komponentë të rëndësishëm për ripërdorimin social por shpërndan pronën e konfiskuar vetëm për të mirën e qeverisë dhe/ose agjencive ligjzbatuese do të kritikohet për neglizhimin e nevojave të komunitetit, veçanërisht në kontekstin e shqetësimeve buxhetore të Kosovës[17].

**<u>Efekti3. Mos stimulimi i organeve të drejtësisë për të ngritur performancen e konfiskimit</u>**

Pavarsishtë kornizës ligjore në fuqi e cila rregullon çështjen e konfiskimit dhe administrimit të saj, numri i rasteve të konfiskimeve të pasurive aktualishtë  mbetet i ultë, edhe për kunder faktit që së fundi është miratuar edhe Ligji për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit, andaj në rritjen e përfërmancës do të  ndikonte edhe stimulimi i agjencive ligjzbatuese që merren me konfiskimin e pasurisë veanarisht prokurorisë dhe gjyqësorit.

## <u>Palët e interesit në bazë të përkufizimit të problemit</u>

Në tabelën e mëposhtme listohen palët e interesit.

**Figura 1: Pasqyrim i palëve të interesit në lidhje me përkufizimin e problemit**

| ***Emri i palës së interesuar*** | ***Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala*** | ***Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)*** |
| --- | --- | --- |
| Ministria e Drejtësisë/Agjencia për administrimin pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar | Mungesa e dispozitave per themelimin e programit të  te konfskimit | Munges e dispozitave ligjore per shfrytezimin e te ardhurave nga krimi per perdorim ijnstitucional dhe shoqerore |

[17] Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë  (PECK III), Dokument Teknik, Shqyrtimi i Koncept Dokumentit të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë (Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara) për krijimin e Fondit të Konfiskimit, faqe 14

| | | |
|---|---|---|
| Prokurori i shtetit | Mundesia per aktivitete nderinstitucionale qe ndikjon ne ngritjen e kapaciteteve profesionale | Funksioni i ndjekjes ushtrohet nga prokurori i shtetit i cili është organ i pavarur në zbatimin e ligjit për ndjekjen e kryesve të veprave penale. |

## Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat të cilat adresohen me këtë Koncept Dokument janë përcaktuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021--2025, por edhe janë saktësuar në mënyrë specifike për qëllime të këtij Koncept Dokumenti, si më poshtë.

**Figura 5 objektivat**

| Objektiva relevante | Emri i dokumentit planifikues relevant |
|---|---|
| *Objektivi strategjik 2*, Avancimi i Sistemit të Administrimit Të Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar dhe Krijimi i Fondit të Veçante nga Pasuria e Mbledhur | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 |
| *Objektivi specifik:* Krijimi i fondit të konfiskimit permes ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuara, | Ky objektiv është saktësuar për qëllime të këtij Koncept Dokumenti. |
| *Objektivi strategjike :* Avancimi i sistemit Administrimit të pasurisë së Sekuestruar dhe të konfiskuar | Plani Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë |
| *Objektivi specifik:*<br><br>Krijimi i fondit të konfiskimit *(Përdorimin e pasurisë së konfiskuar nga institucionet që merren me zbatimin e ligjit dhe ri-përdorimit social si dhe shfrytëzimin për kompensimin e viktimave të krimi e paraparë me legjislacion përkatës(* | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 |

## Kapitulli 3: Opsionet

Ky koncept dokument ka trajtuar të gjitha opsionet me të cilat mund të procedohet në fushën e konfiskimit të pasurisë si dhe krijimit të programit për konfiskim. Siç është potencuar edhe më lartë, kjo është bërë me qëllim që produkti i cili del nga ky koncept dokument, të

jetë sa më i përafërt me standardet bashkëkohore ndërkombëtare të kësaj fushe dhe rrjedhimisht të përmirësojë gjendjen në vend.

Së këndejmi, koncept dokumenti trajton tre opsione kryesore:

**Opsioni1:** *status quo (pa asnjë ndryshim)* sipas të cilit situata aktuale dhe si pasojë vështirësitë e paraqitura në praktikë, do të vazhdojnë së ekzistuari;

***Opsioni2:*** Përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative, *opsion ky i cili ndonëse me potencial të adresoj disa prej problemeve të identifikuara në këtë koncept dokument mirëpo ky opsion ofron zgjedhje të pjesshme të problemit***,**

**Opsioni3**: *ndryshime legjislative*, krijimi i programit përmes linjës së rregullt buxhetore nga mjetet e konfiskuara përmes ndryshimit dhe plotësimit të ligjit aktual të AAPSK-së dhe apo ligjit vjetor për buxhet, i cili në në vete përmban:

- Krijimin e infrastrukturës së përgjithshme ligjore për përdorimin e pasurive të konfiskuara nëpërmes krijimit të një programi të të konfiskimit.
- Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.
- Mundësimi që një pjesë nga programi i i Konfiskimit përmes ndarjeve të rregullta buxhetore të mund të përdoret për ripërdorim shoqëror dhe nevoja institucionalet.

Para se të elaborojmë opsionet e përcaktuara në vazhdim do të shpalosim disa nga praktikat e vendeve të rajonit.

**Fingura 5. Analiza krahasuese**

| Çështja | Mënyra e Rregullimit |
| --- | --- |

| | |
|---|---|
| **Përdorimi i pasurisë së konfiskuar** | **<u>Shqipëria;</u>**<br><br>Në Shqipëri, çështja e përdorimit të pasurisë së konfiskuar është e rregulluar në atë mënyra që bazuar në rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar dhe në raportin e vlerësimit tekniko-financiar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vendos mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara.<br><br>Gjithashtu një fond i veçantë në të cilin mbahen paratë nga pasuritë e konfiskuara, për përdorim të mundshëm në projekte të bashkësisë shtetërore dhe shoqërore është parashikuar në nenin 37 të ligjit 10192 të 2009, të ndryshuar në vitin 2017, Fondi Special për Parandalimin e Krimit. Paratë e mbledhura nga zbatimi i këtij ligji i kontribuojnë një fondi të veçantë për parandalimin e krimit dhe edukimin juridik. Fondi Special dhe shuma e tij përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit. |
| | **<u>Spanja</u>**<br><br>Ky vend ka një fond të veçantë në të cilin mbahen paratë e konfiskuara nga krimet e drogës, dhe ato para përdoren vetëm për programet e rehabilitimit të personave të varur nga drogat. |
| | **<u>Franca</u>**<br><br>Në Francë pasuritë e konfiskuara pas hetimeve kriminale mbi krimin e lidhur me drogat transferohen në Fonds de Concours ( Drug Help Fund) dhe caktohen 35% për policinë kombëtare, 25 % për xhandarmërinë, 20 % në Ministrinë e Drejtësisë, 10% në Doganat dhe 10 % në Ministrinë e Shëndetësisë. |
| | **<u>Mbretëria e Bashkuar</u>**<br><br>Ky vend ka 2 (dy) sisteme. Një për Skocinë (Skema e Shlyerjes) dhe një për Anglinë dhe Uellsin. Për Anglinë dhe Uellsin, fondi përdoret për qëllime sociale dhe gjithashtu për përdorim të qeverisë / shtetit ligjor për fondin e konfiskimit dhe përdorimin e pasurisë. |

***Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)***

Dispozitat aktuale nuk e rregullojnë në mënyrë të detajuar përdorimin e pasurive të konfiskuara, dhe aktualisht nuk ka Fond të Konfiskimit. Mos ndryshimi i politikës aktuale do të pamundësoj shfrytëzimin e pasurisë së konfiskuar, gjithashtu Kosova nuk do të arrijë të përmbush rekomandimet e dhëna nga BE.

Problemet e nxjerrura në pah nga analizat ligjore vazhdojnë d.m.th nuk do të ketë ligj që pasuritë e konfiskuara të mund të përdoren për qëllime shoqërore apo qeveritare, gjithashtu paratë e grumbulluara nga të hyrat e konfiskuara nuk mund të përdoren për programin e kompensimit të viktimave.

***Opsioni 2:* Përmirësimi i zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative**

Opsioni i dytë shqyrton mundësinë e përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime konkrete legjislative, aktualisht Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës është i zbatueshëm sa i përket përdorimit të pasurisë së konfiskuar, d.m.th mundësia e shfrytëzimit të pasurisë së konfiskuar është përcaktuar në nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale, i cili mundëson paraqitjen e një kërkese nga prokuroria në gjykatë për shitjen e pasurive të konfiskuara, dhe të ardhurat nga shitja të përdoren për kompensimin e të dëmtuarit. Mjetet e mbetura i kalohen buxhetit të shtetit.

Gjithashtu, neni 115 paragrafi 6 i KPPK *Thekson që me kërkesë të prokurorit të shtetit, automjetet apo ajroplanët për të cilët është bërë sekuestrimi i përhershëm mund t'i transferohen Qeverisë së Kosovës për shfrytëzim, nëse transferimi i tillë nuk e zbeh mundësinë e të dëmtuarit për të siguruar kompensimin.*

Mirëpo, konsiderojmë që realizimi i kësaj të drejte në praktikë është vështirë i arritshëm kur kemi parasysh faktin që viktimat nuk janë shumë të informuara për të drejtat e tyre të cilat mund t'i realizojnë gjatë procedurës.

Gjithashtu, pika ku ngecet gjatë zbatimit të këtyre dispozitave është se nuk hapë mundësinë e shfrytëzimit të pasurisë së konfiskuar për programet e caktuara të institucioneve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për hulumtimin e veprave penale dhe konfiskimit të pasurisë.

***Opsioni 3: Ndryshimi i politikës ekzistuese***

Grupi punues pasi identifikoi problemet e përdorimit të pasurisë së konfiskuar dhe të ligjit aktual për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, konsideron që opsioni i tretë është përmes procesit të rregullt buxhetor, ashtu siç është përshkruar në Pjesën e katërt të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

Më këto ndryshime do të kompletohet infrastruktura ligjore në fushën e trajtimi të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, ku krahas administrimit do të rregullohet fusha e përdorimit të pasurisë nga institucionet ligjzbatuese të Republikës së Kosovës dhe do të mundësohet ripërdorimi social i pasurive të konfiskuara si dhe do ta ndihmonte Kosovën në alokimin e burimeve të mjaftueshme për të mundësuar arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategjitë dhe Planet e Veprimit, me financimin e këtyre burimeve nga vetë kriminelët.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në të ardhmen

Në tabelën në vijim janë renditur ndikimet më të rëndësishme të identifikuara të dy opsioneve të para. Ndikimet e opsionit të tretë në anën tjetër, do të trajtohen ndaras duke marrë parasysh preferencën-e grupit punues për këtë opsion.

**Figura 6. Përmbledhje e Opsioneve**

| **Përmbledhje e Opsioneve** | | | |
|---|---|---|---|
| **Karakteristikat kryesore** | **Opsioni 1** | **Opsioni 2** | **Opsioni 3** |
| Karakteristikat kryesore të opsionit | Nuk ka ndryshim | Draft im i ri i ligjit | n/a |
| Ndikimet Ekonomike | N/A | N/A | |
| Ndikimet sociale | Krijimi dhe siguria<br><br>Plotësim ndryshimi i ligjit për AAPSK-në dhe krijimi i Fondit të Konfiskimit, është qenësore për objektiven e përgjithshme të luftimit të krimit në secilin vend të botës e Kosova nuk bënë përjashtim.<br><br>Vazhdimi i gjendjes aktuale nuk pasqyron nevojën për përmirësimin dhe avancimin e kësaj fushe. Siç është përcaktuar në përkufizimin e problemit, në praktikë, janë identifikuar shumë probleme të cilat e bëjnë kornizën aktuale ligjore në fushën e konfiskimit të pasurisë jo efikase dhe jo funksionale.<br><br>Marrë parasysh këtë situatë, mund të konkludohet se në aspektin social, skema | Krijimi dhe siguria<br><br>Masat ligjore të propozuara me opsionin e dytë mund të kenë ndikime pozitive sociale meqë të gjitha prej tyre synojnë një zbatim më efikas të sistemit të konfiskimit në vend dhe rrjedhimisht një luftim më të mirë të krimit dhe siguri më të madhe në vend. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | aktuale legjislative nuk ka ndonjë ndikim pozitiv. | | |
| Ndikimet mjedisore | / | / | |
| Ndikimet në të drejtat themelore | / | / | |
| Ndikimi gjinor | Infrastruktura ligjore aktuale nuk ka ndonjë ndikim gjinor të drejtpërdrejt, meqenëse ligjet e aplikueshme adresojnë çështje jo specifike për nga gjinia. | Masat e propozuara nën Opsionin 2 nuk kanë ndonjë ndikim të drejtpërdrejt gjinor, duke pasur parasysh se ligjet e zbatueshme nuk trajtojnë çështje specifike. | |
| Ndikimet në barazinë sociale | Nuk ka ndikime | Nuk ka ndikime | |
| Ndikimet në rini | Nuk ka ndikime | Nuk ka ndikime | |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | / | / | |
| Ndikimi në NVM | / | / | |
| Ndikimi buxhetor | Ky opsion nuk ka kosto shtesë që do ta ngarkonte buxhetin e Kosovës.<br><br>Vlerësimi i ndikimit buxhetor është paraqitur në dokumentin e bashkangjitur [i cili do të hartohet në fazat e mëvonshme të përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti]. | Ky opsion ka një kosto shtesë nominale që e ngarkon buxhetin e Kosovës marrë parasysh fondet të cilat duhet të investohen në ngritjen e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve profesionale. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Vlerësimi i ndikimit buxhetor është paraqitur në dokumentin e bashkangjitur [i cili do të hartohet në fazat e mëvonshme të përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti]. | |

